



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 179, datë 20.11.2019

MBI

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“ALBPETROL” SH.A., NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT  
NATYROR (SHITJE ME PAKICË)”**

Në mbështetje të nenit 4, pika 11, 12 dhe 50; nenit 22, pika 2, gërma “c”; nenit 75, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “c”; nenit 5; nenit 8, nenit 9 pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, “d,” “ e”; pika 2, gërma “e”; dhe nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat ERE-s”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBPETROL” sh.a., dhe relacionin me nr. 102/8 prot, datë 12.11.2019 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për “Mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë)”.

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., me shkresën e saj nr. 9605 prot, datë 25.10.2019, protokolluar në ERE me numrin 683 Prot, datë 30.10.2019, ka paraqitur në ERE aplikimin për fillimin e procedurës për pajisjen me licencë “Furnizimi i Gazit Natyror (shitje me pakicë)”.
- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., nuk ka depozituar në ERE asnjë dokument sipas parashikimeve të nenit 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017.
- Shoqëria ka depozituar në ERE vetëm kërkesën për licencim, por pa e shoqëruar atë me dokumentacionin e nevojshëm e të mjaftueshëm për të legjitimuar shqyrtimin e kërkesës, në kuptim të parashikimeve të Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Nuk rezulton që nga ana e shoqërisë“ALBPETROL” sh.a., të jetë kryer pagesa e aplikimit, sipas parashikimeve të Aneksit A të *Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror*”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Gazit Natyror (shitje me pakicë)”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**